



NJOFTIM PËR MEDIA

Ditën e mërkurë, më datë 27 janar, 2016 u zhvillua mbledhja e radhës së Autoritetit të Mediave Audiovizive në të cilën morën pjesë anëtarët e mëposhtëm:

Z.Gentian Sala	Kryetar
Z.Sami Nezaj	Zëvendëskryetar
Z.Gledis Gjipali	Anëtar
Z.Piro Misha	Anëtar
Zj.Suela Musta	Anëtar
Z.Zylyftar Bregu	Anëtar

AMA në përputhje me rendin e ditës, miratoi vendimet e mëposhtme:

1. Miratimin e rregullores së strukturës organizative të Autoritetit të Mediave Audiovizive.
2. Dhënien e autorizimit shoqërisë “Digicom” sh.p.k., për përsëritjen online të shërbimit të programit audioviziv të të tretëve mbështetur në internet (IPTV).
3. Dhënien e autorizimit shoqërisë “Albtelecom” sh.a., për ofrimin e shërbimit të programit audioviziv online “Tv Info Channel”, mbështetur në internet IPTV dhe OTT.
4. Dhënien e autorizimit shoqërisë “ABCOM” sh.p.k., për shërbimin e programit audioviziv të mbështetur në rrjet kabllor “3N1 TV”.
5. Dhënien e autorizimit personit fizik Erisa Bakalli, për subjektin OSHMA “Durrësi Televizion”, për shërbimin e programit audioviziv të mbështetur në internet “Internet Tv” .
6. Rinovimin e autorizimit lëshuar për subjektin person fizik Ergys Caushi, për përsëritjen e shërbimit të programit audioviziv të të tretëve mbështetur në rrjet kabllor “Tv Kabllor Përrenjas”.
7. Pranimin e kërkesës së shoqërisë “KL-ED KABËLL” sh.p.k., autorizuar për përsëritjen e shërbimit të programit audioviziv të të tretëve mbështetur në rrjet kabllor “Tv KL-ED”, për zgjerimin e zonës së ofrimit të shërbimit nga plazhi Durrës në bashkinë Durrës.
8. Ndryshimin e zonës së ofrimit të shërbimit të subjektit person fizik Arben Asllani, autorizuar për subjektin audioviziv privat kabllor « TV 2Asl » duke hequr nga zona e ofrimit të shërbimit njësinë administrative Funar dhe duke lënë përfundimisht njësitë administrative: Shirgjan dhe Bradashesh.
9. Konstatimin e pavlefshmërisë të autorizimit lëshuar për shoqërinë “Albtelecom” sh.a., për përsëritjen e shërbimit të programit audioviziv të të tretëve mbështetur në rrjet kabllor.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I MEDIAVE AUDIOVIZIVE

10. Konstatimin e pavlefshmërisë të autorizimit lëshuar për shoqërinë “Bleta” sh.p.k., për ripërsëritjen e shërbimit të programit audioviziv të të tretëve mbështetur në rrjet kabllor “TV Bleta”.
11. Konstatimin e pavlefshmërisë të autorizimit lëshuar për subjektin person fizik Elona Shaha për ofrimin e shërbimit online audioviziv “Stream Tv”.
12. Miratimin e kërkesës së shoqërisë “Tok Media” sh.p.k., për ndryshimin e emërimit (logos) së subjektit radiofonik privat vendor nga “Mad Radio Albania” në “IN RADIO 105.7”.

Po ashtu, AMA mori në shqyrtim ankimet administrative ndaj sanksioneve më gjobë të vendosura ndaj subjekteve audioviziv duke vendosur:

1. Rrëzimin e ankimit dhe lënien në fuqi të sanksionit gjobë nr. 53, datë 07.12.2015 të vendosur nga AMA, në masën 1 000 000 (një milion) lekë, ndaj shoqërisë “Focus Media Neës” sh.p.k., për televizionin privat vendor “TV News 24”.
2. Rrëzimin e ankimit dhe lënien në fuqi të sanksionit gjobë nr. 54, datë 07.12.2015 të vendosur nga AMA, në masën 1 200 000 (një milion e dyqind mijë) lekë, ndaj shoqërisë “Top Channel” sh.p.k., për televizionin privat vendor “TV Top Channel”.
3. Rrëzimin e ankimit dhe lënien në fuqi të sanksionit gjobë nr. 55, datë 07.12.2015 të vendosur nga AMA, në masën 1 000 000 (një milion) lekë, ndaj shoqërisë “Media Vizion” sh.a., për televizionin privat vendor “TV Vizion +”.
4. Rrëzimin e ankimit dhe lënien në fuqi të sanksionit gjobë nr. 56, datë 07.12.2015 të vendosur nga AMA, në masën 800 000 (tetëqind mijë) lekë, ndaj shoqërisë “UTV Education” sh.a., për televizionin privat vendor “UTV Education”.
5. Rrëzimin e ankimit dhe lënien në fuqi të sanksionit gjobë nr. 57, datë 07.12.2015 të vendosur nga AMA, në masën 800 000 (tetëqind mijë) lekë, ndaj shoqërisë “Adria Med” sh.p.k., për televizionin privat vendor “TV Adria Med”.
6. Rrëzimin e ankimit dhe lënien në fuqi të sanksionit gjobë nr. 58, datë 07.12.2015 të vendosur nga AMA, në masën 800 000 (tetëqind mijë) lekë, ndaj shoqërisë “Media Motiv” sh.a., për televizionin privat vendor “TV Rozafa”.
7. Pranimin e ankimit dhe shfuqizimin e sanksionit gjobë nr. 46, datë 11.11.2015 të vendosur nga Grupi i Inspektimit, në masën 1 000 000 (një milion) lekë, ndaj shoqërisë “Fokus Cable” sh.p.k., autorizuar për subjektin kabllor “TV Fokus”.
8. Rrëzimin e ankimit dhe lënien në fuqi të sanksionit gjobë nr. 47, datë 18.11.2015 të vendosur nga Grupi i Inspektimit, në masën 1 000 000 (një milion) lekë, ndaj shoqërisë “Devi E.R.I” sh.p.k., autorizuar për subjektin kabllor “TV Devi E.R.I”.
9. Pranimin e ankimit dhe shfuqizimin e sanksionit gjobë nr. 61, datë 15.12.2015 të vendosur nga Grupi i Inspektimit, në masën 1 000 000 (një milion) lekë, ndaj personit fizik Gazmend Doçi, për subjektin kabllor “TV Belsh”.
10. Pranimin e ankimit dhe shfuqizimin e sanksionit me gjobë nr. 64, datë 17.12.2015 të vendosur nga Grupi i Inspektimit, në masën 1.000.000 (një milion) lekë, ndaj shoqërisë “Envo-Company” sh.p.k., për subjektin kabllor “TV Envo-Company”.
11. Pranimin e ankimit dhe shfuqizimin e sanksionit gjobë nr. 44, datë 02.11.2015 të vendosur nga Grupi i Inspektimit, në masën 1.000.000 (një milion) lekë, ndaj shoqërisë “Vlora Cable” sh.p.k., për subjektin kabllor “TV Vlora Cable”.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I MEDIAVE AUDIOVIZIVE

12. Rrëzimin e ankimit dhe lënien në fuqi të sanksionin me gjobë nr. 49, datë 24.11.2015 të vendosur nga Grupi i Inspektimit, në masën 1.000.000 (një milion) lekë, ndaj personit fizik Dritan Xhaçi, për subjektin kabllor “TV Xhaçi”.
13. Pranimin e ankimit dhe shfuqizimin e sanksionin gjobë nr. 48, datë 19.11.2015 të vendosur ndaj shoqërisë “Next-TV” sh.p.k., për subjektin kabllor “TV Next Kabëll”, në masën 5.000.000 (pesë milion) lekë.
14. Pranimin e ankimit dhe shfuqizimin e sanksionit me gjobë nr. 52, datë 04.12.2015 të vendosur ndaj shoqërisë “MRM” sh.p.k., për subjektin kabllor “TV Korça”, në masën 2.000.000 (dy milion) lekë.
15. Pranimin e ankimit dhe shfuqizimin e sanksionit me gjobë nr. 42, datë 27.10.2015 të vendosur nga Grupi i Inspektimit, në masën 1.000.000 (një milion) lekë, ndaj shoqërisë “MRM” sh.p.k., për subjektin kabllor “TV Korça”.
16. Pranimin e ankimit dhe shfuqizimin e sanksionit gjobë nr. 63, datë 17.12.2015 të vendosur nga Grupi i Inspektimit, në masën 1 000 000 (njëmilion) lekë, ndaj personit fizik Dorina Marini, për subjektin kabllor “TV Andor”.
17. Rrëzimin e ankimit dhe lënien në fuqi të sanksionit gjobë nr. 62, datë 15.12.2015 të vendosur nga Grupi i Inspektimit, në masën 2 000 000 (dymilion) lekë, ndaj shoqërisë “Reçi KGM” sh.p.k., autorizuar për subjektin kabllor “TV Lissus”.
18. Pranimin e ankimit dhe shfuqizimin e sanksionit gjobë nr. 65, datë 15.12.2015 të vendosur nga Grupi i Inspektimit, në masën 2 000 000 (dymilion) lekë, ndaj shoqërisë “Reçi KGM” sh.p.k., autorizuar për subjektin kabllor “TV Lissus”.

Tiranë, 27 Janar 2016

AUTORITETI I MEDIAVE AUDIOVIZIVE